

Universiteti i Tetovës
Fakulteti i Shkencave Mjekësore
Cikli i tretë i Studimeve të Doktoraturës

Fakulteti të Shkencave Mjekësore
Këshillit Mësimor Shkencor të FSHM-së
Tetovë

Në bazë të Vendimit Nr. **22-1452 /1** të datës **25.05.2022** për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Nadi Rustemi** të miratuar nga *Këshilli-Mësimor Shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës*, u formua **Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit Nadi Rustemi** me përbërje: **Prof.Dr. Gazmend Kaçaniku, Prof.Ass.Dr.Afrim Shabani, Prof.Dr.Nexhbedin Beadini, Prof.Dr. Nasir Behxheti, Prof.Dr.Nevzat Elezi**. Komisioni për vlerësim të punimit të disertacionit të doktoraturës pas shqyrtimit të kërkesës të kandidatit Nadi Rustemi paraqet këtë:

RAPORT

Për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit Nadi Rustemi me titull: "Efikasiteti i trajtimit kirurgjik të kataraktës me fakoemulsifikim"

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatit Nadi Rustemi si në aspektin strukturor po ashtu edhe në aspektin përmbajtësor dhe hulumtues shkencor i plotëson kriteret e një punimi të mirëfillt të doktoraturës. Punimi i disertacionit të doktoraturës është i konceptuar në Kapituj dhe Nënkapituj dhe në kuadër të punimit janë përfshi: **87faqe, 32 foto,9 tabela 9 grafikone**.

Punimi i disertacionit të kandidatit Nadi Rustemi është i strukturuar për nga aspekti përmbajtësor dhe metodologjik në: **Hyrje, Materiali dhe metodat e punës , Qëllimi i punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, Literatura**.

I. HYRJE

Tek „ **Hyrja**„ kandidatja **Nadi Rustemi** paraqet problematikën kryesore të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke përshkruar dhe cituar literaturë përkatëse të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Katarakti i syrit është një nga problematikat më të shpeshta të moshave të treta. Krijimi i perdes së syrit vihet re më shpesh tek moshat mbi 60 vjeç. Por nuk përjashtohen rastet kur shfaqet edhe te moshat më të reja si pasoja gjenetike, lëndimi apo diç tjetër. Zakonisht, personi që vuan nga kjo sëmundje e humbasë shikimin në mynyrë graduale. Simptomat e para janë paraqitja e pamjeve të dyfishta me njërin sy, humbje të aftësisë për të parë si dhe vështirësi të dallimit të objekteve. Kur personat kanë kësi probleme me shikimin duhet të paraqiten te oftalmologu më i afërt. Ai më pas do bëjë vlerësimin e gjendjes së syrit duke ofruar terapi përkatëse shëruese ose planifikim të kryerjes së ndërhyrjes kirurgjikale. **Prezenca** e një vel i zi në sy i cili bllokoi shikimin duke e dëmtuar atë ditë pas dite shumë është arsyeja që një oftalmolog do sugjeronte një ndërhyrje kirurgjikale. **Ky** operacioni do largoj kataraktën (ndryshe e njohur si perdja e syrit) dhe më pas vendosja e lentes për të rikthyerje të shikimit.

Simptomat dhe shkaktarët e paraqitjes së kataraktës

Shpesh katarakte zhvillohet ngadalë. Njerëzit zakonisht nuk e kuptojnë se shikimi i tyre është përkeqësuar deri sa katarakte ndërhyjnë në diçka që ata duan ta bëjnë. Disa njerëz fillojnë të kenë probleme të lexojnë, shikimi i TV. Për shkak se ndryshimi në shikim është aq gradual, shumë njerëz janë të bindur se bota dhe jo shikimi i tyre ka ndryshuar.

Ju mund të ndjeni simptoma në të dy sytë ose vetëm në një sy. Shenjat e kataraktës përfshijnë:

- *Pamje të paqarta ose të turbullta*
- *Ndryshim në gjallërinë e ngjyrave ose zverdhje e ngjyrave*
- *Vështirësi me shikimin gjatë natës, i dobët, me shkëlqim rreth dritave të rrugës dhe veturave*

- *Ndjeshmëria ndaj ditës dhe shkëlqimit, nevoja për dritë më të ndritshme për lexim dhe aktivitete të tjera.*
- *Shikim i dyfishtë*
- *Ndryshime të shpeshta në recetën tuaj për syze ose kontakte.*

A është moshë i vetmi faktor që shkakton kataraktë. Megjithatë plakja është shkaku më i zakonshëm i kataraktës, edhe një sërë arsyesh të tjera shkaktojnë kataraktë. Kataraktet mund të jenë kongjenitale (të pranishme gjatë lindjes), metabolike (e shkaktuar nga kimikate të prodhuara në trupin tuaj), toksik (nga medikamentet ose kimikate të tjera të jashtme), ushqyese (nga mungesa e vitaminave ose mineraleve), postkirurgjikale (si rezultat i operacionit paraprak të syrit), traumatike (nga dëmtime të forta ose të mprehta), ose sekondare (lidhur me sëmundje të tjera të trupit, rrezatim, ose ndonjë shkak tjetër që nuk ka lidhje me moshën). Me pak fjalë, ka shumë gjëra që mund ta dëmtojnë syrin dhe të shkaktojnë formimin e një katarakte.

Për ta përmbledhur, nëse nuk plakeni, kurrë nuk jeni të ekspozuar ndaj diellit ose ndonjë burimi tjetër të dëmtimit oskidativ, nuk keni sëmundje të syrit dhe gëzoni ushqim të përsosur, atëherë mund të jeni në gjendje të shmangni kataraktën. Për pjesën tjetër rreth nesh që jemi thjesht njerëz të vdekshëm, është një përfundim i pashmangshëm që jeta të çon në një katarakt. Ekzistojnë disa lloje të katarakteve^{38,39,40}.

I. QËLLIMI I PUNIMIT:

Tek „**Qëllimi i punimit**„ kandidati **Nadi Rustemi** paraqet problematikën kryesore të qëllimit të punimit të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar qëllimin esencial të fushës shkencore hulumtuese të këtij punimi.

Disertacioni i doktoratës ka për qëllim të:

- përcaktoj llojin më të shpeshta të kataraktës,
- moshën më të prekur nga katarakta,
- gjinia më e prekur nga katarakta,
- komplikimet intra operative dhe postoperative,
- avantazhet e operimit dhe mjekimit me PHAKO kundrejt ECCE.

II. MATERIALI DHE METODAT:

Tek „ **Materiali dhe metoda e punës,**” kandidati **Nadi Rustemi** paraqet problematikën kryesore të metodologjisë hulumtuese të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar metodologjinë kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Gjatë realizimit të këtij studimi do të shfrytëzohen metoda analitike, krahasimore dhe deskriptive me çrast do ofrohen konkluzionet dhe rekomandimet e studimi. Me qëllim të analizimit dhe diskutimit të hipotezave të parashtruara studimi bazohet në materialin e repartit të syve, në librin e shënimeve të operacioneve të kryera dhe dokumentacioneve tjera ekzistuese në repartin e Syve pranë Spitalit Klinik të Tetovë, gjatë vitit kalendarik janar 2017 dhjetor 2020. Te pacientët që janë mostër e këtij punimi është aplikuar protokollit standard për operacionin e kataraktës me metodën e ekstraksionit ekstrakapsuar (ECCE) dhe me metodën e fakoemulzifikimit (PHAKO). Në studimin tonë janë përfshirë 250 pacient prej moshës 51 deri 90 vjeç të operuar me metodën e fakoemulsifikimit [FAKO] dhe 50 pacient të operuar me metoden ECCE.

Të gjithë pacientët janë operuar nga katarakta me aplikimin e protokollit standard për operacionin e kataraktës me metodën e ekstraksionit ekstrakapsuar (ECCE) dhe me metodën e fakoemulzifikimit (PHAKO).

Data baza e këtij punimi është formësuar nga të dhënat e regjistrit të pacientëve të repartit të Oftamologjisë në Spitalin Klinikë të Tetovës. Më pas të dhënat e krijuara do të përpunohen me metoda statistikore nga të cilat do rezultojnë prezantimet tabelare dhe grafike. Nga të dhënat e fituara do nxjerrim konkluzionet të rëndësishme për dukurin e hulumtuar në këtë punim të doktoratës.

III. REZULTATET:

Tek „**Rezultatet**„, kandidati **Nadi Rustemi** paraqet me anë të tabelave dhe figurave problematikën kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Tek rezultatet kandidati ka paraqitur të dhënat e fituara për dy grupet e pacientëve të pëfshira në studim dhe më pas kandidati ka bërë krahasimin edhe ndërmjet grupeve. Rezultatet e fituara do të japin një kontribut të çmuar për efikasiteti e këtij operacioni dhe sherimi dhe komoditetin e shpejt të pacientëve pas operacionit. Rezultatet e fituara do ti shërbejnë fushës së Oftalmologjisë.

Nga hulumtimi empirik i doktoratës priten të jenë në të njëjtën vij nivel si edhe të shumë autorëve të tjerë në regjion dhe në vendet më gjërë.

IV. DISKUTIMI

Tek „**Diskutimi**„, kandidati **Nadi Rustemi** ka paraqitur në mënyrë shumë të detajuar problematikën e fushës hulumtuese dhe ka bërë krahasimin e vlerave të fituara në punimin e kandidatit me vlerat e shumë autorëve botëror që merren me problematikën e kësaj fushe hulumtuese.

V. KONKLUZIONI

Tek „**Konkluzioni**„, kandidati **Nadi Rustemi** paraqet problematikën kryesore dhe përfundimtare të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke dhënë rekomandimet përfundimtare dhe finale të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Operacioni i kataraktës është një ndër procedurat më të shpeshta të operimit. Komplikimet pasoperative, edhe pse të pashmangshme, nëse i nënshtrohen disa masave efikase

preventive si diagnostifikimi në kohë dhe menaxhimi i përshtatshëm i komplikimeve, mund të ulin rrezikshmërinë e sëmundjes së syrit.

Anestezioni adekuat, syri i butë paraoperativ, dekontamini i qeskës konjuktivale me “jod-povidon”, vitrektomia adekuate te pacientët me humbje të thjerrëzës, vlerësimi “retinal periferik para dhe pas operacionit te pacientët me miopi”, mbyllja adekuate e plagës dhe “vëmendja në lidhje me shfaqjen e edemës cistike makulare”, mundësojnë uljen e incidencës për komplikime në operacionin e kataraktës.

Metoda e fakoemulsifikimit është shumë efikase në trajtimin e kataraktës, shërim i shpejtë, pacienti është i aftë të funksionojë i pavarur që ditën e nesërme.

Ne rekomandojmë që kontrolli me kohë i pacientëve që shfaqin probleme me shikimin, mundësojmë rezultate më të mira të operacionit dhe shërim më i shpejtë dhe efikas.

Rekomandojmë gjithashtu pacientët që vuajnë nga diabeti, të bëjnë kontroll të rregullt te endokrinologu dhe oftalmologu duke patur parasysh se nje diabet i kontrolluar mirë, ndihmon shumë në efikasitetin e operacionit të kataraktës.

VII. BIBLIOGRAFIA

Tek „ **Bibliografia**„ kandidati **Nadi Rustemi** paraqet problematikën kryesore të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke përshkruar dhe cituar literaturë përkatëse të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Tek ky punim doktore që është i fokusuar në literaturën me standarde bashkëkohore, në mënyrë të drejtë janë cituar referencat e punimit të doktoraturës. Këto referenca të cituara e plotësojnë dhe i japin një karakter edhe më përmbajtësorë punimit të doktoraturës sepse u përkasin referencave më bashkëkohore të cituara me impakt ndërkombëtar, prandaj shiquar edhe nga ky aspekt ky punim i plotëson standardet bashkëkohore të një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Duke u bazuar në të dhënat e punimit të disertacionit të doktoraturës, konsiderojmë se ky punim i disertacionit do të sjell dobi në fushën e Oftalmologjisë për zbulim sa më të hershëm të kataraktës dhe llojin e operacionit të aplikuar, duke aritur shërim të shpejt efikas dhe komod për pacientin. Prandaj konsiderojmë se ky punim do të kontribjë në fushën e Mjekësisë në përgjithsi dhe fushës së Oftalmologjisë në veçanti, prandaj duke u bazuar në këto të dhëna të mirëfillta, kërkojmë nga **Këshilli Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore**, që ta miratojë punimin e disertacionit të doktoraturës së kandidatit **Nadi Rustemi** me titull: **“Efikasiteti i trajtimit kirurgjik të kataraktës me fakoemulsifikim”**.

Tetovë 30.05.2022

Anëtarët e komisionit:

Prof.Dr. Nevzat Elezi - mentor

Prof.Dr. Nexhbedin Beadini - anëtar

Prof.Dr. Gazmend Kaçaniku - anëtar

Prof. Ass.dr. Afrim Shabani- anëtar

Prof. Dr. Nasir Bexheti – anëtar
